

VENDIM
Nr. 11, datë 10.3.2016

**PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR VITIN 2016, PËR DISA PROJEKTE NË VAZHDIM,
TË GRANTIT “SHQIPËRIA DIXHITALE”, PROGRAMI “SHQIPËRIA DIXHITALE”,
SHTYLLA III, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 13, DATË 25.2.2015,
DHE VENDIMIN NR. 21, DATË 16.3.2015, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim, me cikël financimi 2015–2016, për grantin “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 13, datë 25.2.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për programin “Shqipëria dixhitale”, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhen disa ndryshime, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 21, datë 16.3.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për programin “Shqipëria dixhitale””, bëhen disa ndryshime, sipas tabelës 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Fondi i përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit, miratuar sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të saj, si dhe nga pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, për projektet me cikël financimi 2015–2016, i shtohet portofolit të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, për vitin 2016. Ky fond shpërndahet për financimin e projekteve të thirrjes I, të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve me cikël financimi 2015-2016, financuar përmes grantit Shqipëria dixhitale, programi i Shqipërisë dixhitale, shtylla III, financimi për vitin 2016

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e Projektit (në lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)/veprimi korrektues (*)
1	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Kontrata kuadër për shkrim projektsh në favor të zgjidhjeve smartcity për bashkitë.	10,000,000	9,336,000	664,000	7,000,000	2,336,000
2	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Përmirëso qytetin	30,000,000	25,173,000	4,827,000	30,000,000	- 4,827,000*
3	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Lidhja e komisariteve dhe DPPSH me rrjetin GovNet	44,600,640	43,470,000	1,130,640	44,600,640	- 1,130,640*
4	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	E-Egzaminime (Sistemi i menaxhimit të radhës për egzaminime të avancuara mjekësore)	57,720,000	42,006,000	15,714,000	57,720,000	-15,714,000*
5	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Shtimi i 209 shërbimeve të reja elektronike për 18 institucione në portalin e-Albania (Faza I)	332,053,334	263,866,954	68,186,380	166,026,667	97,840,287
6	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Sistemi multifunksional i qendërzuar i lejeve të ndërtimit e-lejet	115,200,000	80,717,357	34,482,643	80,640,000	77,357
7	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Promovim dhe vendosje sportesh dixhitale për portalin e-Albania (Faza Pilot)	7,920,000	7,110,000	810,000	5,940,000	1,170,000
8	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Implementimi i shërbimeve online të MPJ	56,337,316	33,459,120	22,878,196	28,168,658	5,290,462
9	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (Institut i Sigurimeve Shëndetësore)	Zgjerimi i shërbimeve të ISSH (Institut i Sigurimeve Shëndetësore)	51,408,000	49,297,500	2,110,500	51,408,000	- 2,110,500*
10	Ministria e Mirëqënies Sociale	Ngritja e regjistrit elektronik për personat me aftësi të kufizuara	175,100,000	119,993,592	55,106,408	122,299,104	-2,305,512*
11	Departamenti i Administratës Publike	Përdorimi i platformes "Cloud" për rritjen e efikasitetit në menaxhimin e burimeve njezore në administratën publike	12,080,000	8,972,496	3,107,504	12,080,000	- 3,107,504*
12	Departamenti i Administratës Publike	Sigurimi i infrastrukturës teknike për menaxhimin qendror të provimeve dhe rekrutimeve për Departamentin e Administratës publike	21,627,060	11,971,248	9,655,812	21,627,060	- 9,655,812*
13	Ministria e Punëve të Brendshme	Sistemi multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e policisë së Shtetit (Loti I)	540,533,139	460,253,352	80,279,787	378,373,197	81,880,155
14	Ministria e Shëndetësisë	Implementimi i nënshkrimit elektronik për qytetarët dhe profesionistët e shëndetësisë për përdorimin e shërbimeve të shëndetësisë elektronike	147,180,000	128,578,800	18,601,200	73,590,000	54,988,800
15	Ministria e Kulturës	Regjistrimi i Pasurive Kulturore Kombëtare në qendrat e Regjistrimit fizik dhe online	45,429,718	33,908,635	11,521,083	31,800,803	11,521,083
16	Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike (Qendra e ofrimit të shërbimeve publike të integruara)	Ri-Inxhinierimi i shërbimeve dhe menaxhimi i sporteve nga Qendra e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara	163,749,775	126,955,848	36,793,927	163,749,775	- 36,793,927*

17	Ministria e Zhvillimit Urban (Arkivi Qendror Teknik i Ndertimit)	Shërbimet online të Arkivit Qendror Teknik të Ndertimit dhe shkëmbimin dixhital të informacionit me entet publike (Integrimi i 5 shërbimeve ne platformën e-albania)	96,847,825	69,873,518	26,974,307	58,108,695	11,764,823
18	Ministria e Drejtësisë (Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave)	Sistem Eeb-GIS Inforancioni për regjistrimin dhe vlerësimin e pronave objekt Kthimi dhe Kompensimi "Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave -Eeb-GIS" (Shërbimet online për qytetarët)	123,664,000	119,974,728	3,689,272	74,198,400	45,776,328
19	Ministria e Punëve të Jashtme	Informatizimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe krijimi i bazës së sistemit për Konsullatën Dixhitale.	125,335,800	118,996,800	6,339,000	62,667,900	56,328,900
20	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Implementimi i sistemit për njoftimin dhe konsultimin publik.	11,288,534	11,109,783	178,751	1,128,853	9,980,930
TOTAL			2,168,075,141	1,765,024,731	403,050,410	1,471,127,752	303,310,230

Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe "korrekton" vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike).
3. "Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës", përfaqëson vlerën e përfutur nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës. Fondi i krijuar nga kjo difference i shtohet fondit të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, dhe shpërndahet në thirrjen e radhës, sipas specifikës së thirrjes.
4. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
5. "Vlera e financimit", për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2015. "Veprimi korrektues" është vlera me minus që zvogëlon vlerën e financimit për vitin 2015, kur financimi i vlerës së projektit dhe/ose i vitit 2015, mbas nxjerrjes së vlerës së kontratës (nënshkrimit), duhet zbritur respektivisht. Financimi i papërdorur tërhiqet në zarinë të grantit përkatës. Financimi 2016 për këto projekte është në vlerën 0 Lekë.

Tabela 2. Ndryshim në vendimin nr.13, datë 25.2.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr.8, si më poshtë vijon, në tabelën 1 të këtij vendimi i anulohet financimi.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
8	Bashkia Korçë	Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes monitorimit digjital	89,000,000	62,300,000	26,700,000

Shënim:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr.1440 prot, datë 2.3.2016, për shkak të mos prokurimit nga Autoriteti Kontraktues, i financimit të miratuar.
2. Totali i vlerës së projektit si dhe vlera e financimit për vitet 2015 dhe 2016, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.13, datë 25.2.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në Lekë)
	TOTALI		587,066,100	461,350,000	125,716,100

3. Numri rendor i totalit të projekteve, në tabelën 1 të këtij vendimi ndryshon, nga 9 projekte bëhet 8 projekte.

Tabela 3. Ndryshim në vendimin nr.21, datë 16.3.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr.1, si më poshtë vijon, në tabelën 1 të këtij vendimi i anulohet financimi.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
1	Bashkia Durrës	Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes monitorimit digjital	78,412,800	54,888,960	23,523,840

Shënim:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr.1440 prot, datë 2.3.2016, për shkak të mos prokurimit nga Autoriteti Kontraktues, i financimit të miratuar.
2. Totali i vlerës së projektit si dhe vlera e financimit për vitet 2015 dhe 2016, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.21, datë 16.3.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në Lekë)
	TOTALI		585,133,779	422,973,837	162,159,942

3. Numri rendor i totalit të projekteve, në tabelën 1 të këtij vendimi ndryshon, nga 3 projekte bëhet 2 projekte.